

Të drejtat e tua kur blen një paketë udhëtimi

Çdo herë që rezervon një paketë udhëtimi, si konsumator ke të drejta të mbrojtura me ligj që garantojnë një eksperiencë të drejtë, të sigurt dhe pa surpriza të pakëndshme.

 **Kontrata e paketës është dokumenti yt kryesor.** Ajo duhet të përfshijë të gjitha detajet e udhëtimit si p.sh.:

- të dhënat e operatorit turistik dhe të siguruesit,
- mënyrat, karakteristikat dhe kategorinë e transportit,
- akomodimin,
- çmimin e plotë të paketës,
- destinacionin dhe itinerarin,
- afatet dhe kushtet për anulim,
- kontaktin për ndihmë gjatë udhëtimit,
- përgjegjësitë në rast ndryshimesh apo mosrealizimi të shërbimeve etj.

 **Ke të drejtë të informohesh me shkrim për të gjitha kushtet** përpara se të firmosësh dhe të pajisesh me një kopje të kontratës. Organizatori ose shitësi janë ligjërisht përgjegjës për mbajtjen e premtimeve të dhëna.

 **Sigurimi i detyrueshëm është një garanci thelbësore:** ai mbulon kthimin e shumave të paguara, kompensimin për shërbimet e munguar dhe riatdhesimin. Kjo mbrojtje është jetike sidomos në rast falimentimi ose paafësie paguese të operatorit. Nëse operatori nuk ka kontratë sigurimi, ti ke të drejtë të heqësh dorë nga udhëtimi pa penalizime.

 Kujdes nga ofertat që nuk përmbajnë të dhëna për siguruesin, afatet e informimit, apo për shërbimet e përfshira në çmim.

Nëse diçka nuk shkon gjatë udhëtimit, **ke të drejtë të ankoresh dhe të kërkohsh kompensim**, për të gjitha dëmet, materiale dhe jomateriale, të shkaktuara nga mospërmbushja ose përmbushja e papërshtatshme e kontratës së paketës së udhëtimit.

Për më shumë informacion, luteni të konsultoheni me ligjin nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 65, datë 21.1.2009 “Për kontratat e paketave të udhëtimit”, si dhe ligjin nr.93/2015 “Për Turizmin” në Republikën e Shqipërisë.

Ky është një fragment nga vendimi i Këshillit të Ministrave “Për Kontratat e Paketave të Udhëtimit”:

“ 40. Organizatori i paketës së udhëtimit duhet të ketë një kontratë sigurimi të detyrueshme, që mbulon përgjegjësinë e tij për dëmet e shkaktuara, si rezultat i mospërbushjes së detyrimeve, përfshirë rastet e paaftësisë paguese dhe falimentimit. Kontrata e sigurimit lidhet me një shoqëri sigurimi, në përputhje me dispozitat e parashikuara në legjislacionin në fuqi, për sigurimin dhe risigurimin, dhe mbulon:

- a) kthimin e parave të paguara nga konsumatori, sipas kontratës së paketës së udhëtimit;*
- b) kompensimin e diferencës, nëse gjatë paketës së udhëtimit përmbushen vetëm një pjesë e shërbimeve të kontraktuara;*
- c) shpenzimet për kthimin e konsumatorit në vendin e nisjes.*

41. Kur organizatori ose shitësi i paketës së udhëtimit nuk është në gjendje t'i sigurojë konsumatorit kontratën e vlefshme të sigurimit, sipas pikës 40 të këtij vendimi, konsumatorit i lind e drejta të heqë dorë nga kontrata e paketës së udhëtimit, pa asnjë shpenzim a penalizim.

42. Heqja dorë e konsumatorit nga kontrata e paketës së udhëtimit, sipas pikës 41, të mësipërme, bëhet me shkrim tek organizatori ose shitësi, përpara nisjes.

43. Kontrata e sigurimit, sipas pikës 40 të këtij vendimi, lidhet për një afat 1-vjeçar, dhe jo më vonë se 30 ditë përpara mbarimit të këtij afati, kontrata rinovohet ose lidhet një kontratë e re.

44. Kushtet dhe procedurat e lidhjes së kontratës së sigurimit, si dhe kufijtë e mbulimit të sigurimit të kësaj kontrate, sipas pikës 40 të këtij vendimi, përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të ministrit të Financave, me propozimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.”